



## Republika e Kosovës - Republic of Kosova

### Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës The Union of Education, Science and Culture

Rr. Agim Ramadani p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë, Tel/Fax: +381(0)38/226-940  
[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org) E: [sbashk2004@yahoo.com](mailto:sbashk2004@yahoo.com), [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Publikuar më: 14.04.2022

#### **Kongresi i 8-të i SBASHK-ut miraton:**

#### **Rezoluta për luftimin e masave shtrënguese për të mbrojtur të drejtat, statusin, vendet e punës dhe pagat**

1. Duke vërejtur se politikat shtrënguese po rriten në të gjithë botën e në kuadër të kësaj edhe në Kosovë, nën kujdesin e Qeverisë së Kosovës me pagat fiskale të miratuar dhe të paralajmëruar për miratim të mbështetura edhe nga Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimit Evropian, në mënyrë që t'u përgjigjen kërkesave të tregjeve financiare, gjithnjë po e synojnë të vendosin barrën e krizës mbi supet e punëtorëve, të cilët nuk janë në asnjë mënyrë përgjegjës për krizën ekonomike dhe financiare;
2. Duke vërejtur se këto politika shoqërohen nga një ulje e taksave mbi fitimet dhe ulje të tatimit në vlerën e shtuat të disa artikuj, për punëdhënësit, duke çuar në zvogëlimin e të ardhurave tatimore, e duke dëmtuar në këtë mënyrë sektorin publik të burimeve;
3. Duke vërejtur se këto politika përkthehen në shkurtime masive të buxhetit që kanë një efekt katastrofik mbi arsimin e shpesh edhe me shkurtimin e vendeve të punës dhe se sektori privat po luan një rol gjithnjë e më të madh në arsimin publik;
4. Duke vërejtur se këto politika kanë rezultuar në shumë vende në largimin e mësuesve ose mbetjen jashtë listës së pagave me muaj të tërë ose duke mos i paguar në shumicën e rasteve angazhimin shtesë dhe se mësuesit janë në një situatë gjithnjë e më të pasigurt;
5. Duke vërejtur se pagat e personelit të arsimit janë nën sulm të vazhdueshëm, duke tentuar se futja e pagës së performancës krijon pabarazi dhe se përparësitë që u jepen disa vijnë me çmimin e reduktimeve të pagave për shumicën dërrmuese të stafit;
6. Duke vërejtur se kushtet e punës po bëhen gjithnjë e më të vështira me klasa gjithnjë e më të mbipopulluara sidomos në qytete;
7. Duke vërejtur gjithashtu që stabiliteti i punës nuk është më i garantuar për një numër të konsiderueshëm mësuesish, gjë që bie në kundërshtim me:
  - a. Rekomandimi i ILO / UNESCO 1966: "OIT / UNESCO de 1966:" Stabiliteti i punësimit dhe siguria e zotërimit në profesion janë thelbësore në interes të arsimit, si

në atë të mësuesit dhe duhet të ruhen edhe kur bëhen ndryshime në organizimi ose brenda një sistemi shkollor;

- b. Rekomandimi i UNESCO-s për vitin 1997 lidhur me Statusin e Personelit të Mësimdhënies në Arsimin e Lartë: «Siguria e punësimit në profesion, duke përfshirë qëndrimin ose ekuivalentin e tij funksional, aty ku është e aplikueshme, duhet të ruhet, pasi është thelbësore për interesat e arsimit të lartë si dhe për personelin mësimor të arsimit të lartë;

**8.** Duke riafirmuar se është shumë e rëndësishme që mësuesit të gëzojnë status të lartë jo vetëm për shkak të vetë cilësisë së arsimit, por edhe për ecurinë e të gjitha shoqërive ( EI Washington Congress );

**9.** Duke shprehur solidaritetin e saj me të gjithë kolegët tanë sindikalist që luftojnë për t'i mbrojtur kërkesat dhe të drejtat e tyre, për të mbrojtur arritjet e tyre demokratike dhe sociale, për të drejtën për arsim, trajnimin dhe punës, për të drejtën për punë të mbrojtur nga kontrata kolektive dhe statutet, shpesh të detyruara në veprim të grevës

**10.** Duke vërejtur se këto sulme kanë për qëllim shkatërrimin e të drejtave, për të cilat punëtorët dhe demokratët kanë luftuar për më shumë se një shekull, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

**11.** Duke vërejtur se shpeshherë edhe përkundër ligjeve dhe akteve tjera ligjore të miratuara në heshtje dëmtohen punonjësit arsimor çoftë në paga apo u shkelen të drejtat që ju garanton kontrata kolektive.

### **Kongresi i 8 i SBASHK-ut për këtë arsye:**

1. ***Obligon Kryetarin e SBASHK-ut, Këshillin Drejtues dhe Kryesinë e SBASHK-ut*** , në bashkëpunim me organizatat tjera që merren me çështje të arsimit në Kosovë, të:
  - a. Denoncon planet e ashpra, të cilat kanë një efekt shkatërrues në arsim dhe rini dhe luftojnë kundër rritjes së pasigurisë në profesionin e arsimit, për t'i dhënë fund shkarkimeve.
  - b. Të bënë presion për krijimin e programeve për të forcuar ose rindërtuar sektorin publik në vend të «**planeve të shpëtimit**» dhe programeve të rregullimit strukturor.
  - c. Të mbrojnë dhe forcojnë rekrutimin e personelit të arsimit në bazë të punës së përhershme të garantuar me statut dhe të ndërmarrë veprime për të garantuar sigurinë e mbajtjes së të gjithë personelit arsimor në një situatë të pasigurt.
2. ***Obligon Kryetarin e SBASHK-ut, Këshillin Drejtues dhe Kryesinë e SBASHK-ut*** për të:
  - a. Ngritur një fushatë për të mbrojtur sigurinë e zotërimit të mësuesve të garantuar me një statut.
  - b. Të bëjnë presion për kërkesat e mësipërme duke lobuar fuqishëm organizatat relevante

ndërqeveritare, si UNESCO, UNICEF, ILO, OECD, Banka Botërore dhe FMN, dhe duke siguruar që këto kërkesa t'i bëjnë të njohura gjithë botës dhe publikojnë rregullisht raporte mbi progresin e bërë në përmbushjen e këtyre kërkesave.

Kjo duhet të bëhet në mënyrë që të sigurohet respektimi i rekomandimeve të mësipërme dhe se cilësia e arsimit ka përparësi mbi kthimet ekonomike.

3. ***Obligon Kryetarin e SBASHK-ut***, për të:

- a. Denoncuar shkeljet e tilla ligjore dhe t'i luftojë me të gjitha mjetet e lejuara këto dukuri të cilat e qëmtojnë anëtarin e SBASHK-ut.
- b. Të kërkojë nga organet e drejtësisë kur bëhen shkelje të tilla që të hetohen dhe dënohen përgjegjësit që nuk zbatohen aktet ligjore në fuqi e aq më tepër ku bëhen mashtrime.
- c. Të bëjnë presion, që marrëveshjet e nënshkruar me punëdhënësit dhe organet shtetërore t'i mbrojnë duke përdorur të gjitha veprimet sindikale deri te greva e përgjithshme deri në realizim të kërkesave.

Paraqitësi i Rezolutës, Ymer Ymeri

*Prishtinë, më 02.04.2022*